



Republika e Kosovës / Br. 1071-2019
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 16.09.2019, merr këtë:

VENDIM

për akreditim të grupit të dytë të vëzhguesve të Organizatës Joqeveritare Demokracia për Zhvillim-D4D

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të dytë të Vëzhguesve të Organizatës Joqeveritare (OJQ) vendore 'Demokracia për zhvillim' me akronim D4D, me pesëmbëdhjetë (15) vëzhgues, sipas listës së bashkëlidhur këtij vendimi, për vëzhgimin e aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me 6 tetor 2019.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë OJQ-në 'Demokracia për Zhvillim' me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë OJQ-në 'Demokracia për Zhvillim' për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtinë, 17.09.2019
Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.